



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 85/15

Nr. i fq. / Br. st -7-

Data: / Datum 30.04.2015

VUSHTRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E III-të E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË,
MBAJTUR MË 26 MARS 2015

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën **10:09**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:
Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Para se të fillojnë punimet e mbledhjes së Kuvendit të komunës u mbajt një minutë heshtje në shenjë respekti për vdekjen e kryetarit të Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve, të ndjerin Xhafer Istrefi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Smajl Haziri, përfaqësues i lagjes “Kalaja”- në emër të banorëve të rrugës “Avni Kutllovci” kërkoi nga institucionet e Komunës së Vushtrrisë që ta zgjidhin çështjen e objektit të improvizuar për kryerjen e riteve të fesë islame, pasi që i njëjti mund të prodhojë konflikt, duke shtuar se nuk do të ketë qetësi përderisa nuk zgjidhet ky problem. Pastaj tha se si rezultat i funksionimit të objektit të improvizuar, banorët e lagjes kanë probleme me qarkullimin rrugor, pasi që rruga mbyllet nga veturat e atyre që vijnë në këtë objekt.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me problemin e ngritur nga përfaqësuesi i lagjes në fjalë, tha se nuk është hera e parë që debatohet për këtë çështje, duke shtuar se është një kontest në mes të disa banorëve të asaj lagjeje dhe Këshillit të Bashkësisë Islame në Vushtri. Pastaj tha se objekti i improvizuar që nga paslufta ka filluar aktivitetin e vet si xhami, dhe janë bërë përpjekje të vazhdueshme nga organet komunale që në bashkëpunim me policinë, bashkësinë islame dhe përfaqësuesit e lagjes për të arritur një kompromis, dhe si rezultat i këtyre angazhimeve ekzekutivi i komunës ia ka propozuar për aprovim kuvendit të komunës një parcelë për ndërtimin e xhamisë, por vendimi i aprovuar nga kuvendi i

komunës u konstatua se është i kundërligjshëm, pasi që nuk kishte marrë votat e nevojshme për aprovim, pasi që është dashtë të jenë 18 vota “për”, kurse kanë qenë vetëm 16 vota “për”. Në fund tha se nuk është në rregull që komuna të urdhërojë mbylljen e xhamisë, por në mbledhjen e radhës së kuvendit të komunës do të procedohet përsëri një propozim-vendim për dhënien e pronës së paluajtshme komunale për Këshillin e Bashkësisë Islame për ndërtimin e xhamisë, në mënyrë që të zgjidhet problemi në fjalë.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me vota unanime aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe realizimin e investimeve kapitale, si dhe Raporti i KKSB-së.
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transportin rrugor në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblime për nxënës (shqyrtimi i parë).
6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve.
7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për hapjen e trasesë së rrugëve për vitin 2015.
8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacioneve për parkingje publike.
9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejin e mjeteve financiare për renovimin e zyrave të Shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dobësuar “Drita Jonë”.
11. Shqyrtimi i Korrigjimit të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, konform kërkesës së komisionit të përbashkët MF/MAPL.
12. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet me vota unanime procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe realizimin e investimeve kapitale, si dhe Raporti i KKSB-së.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me raportin në fjalë.
Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur me raportin në fjalë paraqiti këto vërejtje: te faqja 10 pyeti se kush janë përfituesit e subvencioneve; cilat janë rezultatet nga subvencionet; a kanë gjeneruar këto subvencione vende te reja te punes apo edhe rritje të prodhimit etj; te faqja 12- tek Sektori i pyjeve, kur flitet tek pyllëzimet dhe ripyllëzimet vërehet se në tabelë pika 12 dhe 13 shihet që nuk ka pasur pyllëzime, shtrohet pyetja pse?. Gjithashtu tek fletëparaqitjet për kundërvajtje, na intereson të dimë se sa kundërvajtje kanë qenë për prona publike dhe sa per ato private; te faqja 15 – pika 12, flitet për asfaltimin e rrugëve lokale në fshatin Samadrexhë, ku në disa rrugë të këtij fshati ka filluar çarja e asfaltit, edhe pse janë rrugë të shtruara kohëve të fundit; te faqja 17 - pika 43, flitet për ndërtimin e ambulancës, rregullimin e oborrit dhe të rrethojës, kurse kemi vërejtur se në këtë ambulancë nuk ka as oborr e as rrethojë; te faqja 17 – pika 52, ndërtimi i shkollës në Pestovë,

në këtë shkollë të re kemi gjetur shumë mangësi, duke filluar nga izolimi i dobët që si pasojë ka lagështi dhe myk nëpër muret e pothuajse të gjitha klasëve, ndër to edhe klasës së parashkollorëve, sepse në këtë shkollë ka rrjedhje të ujit nga gypat në toaletet e reja, ndërsa një tjetër gjë shqetësuese është mungesa e rrethojave të oborrit të shkollës, kur dihet se shkolla në të dy anët e saj kufizohet me rrugë lokale shumë të frekuentuara. Gjithashtu në këtë shkollë është investuar një shumë prej 7438 euro për ndërtimin e një aneksi në të cilin është vendosur ngrohja qendrore, prandaj pyeti se si ka mundësi që një aneks me dimensione afërsisht 4x5 m² të kushtojë 7438 euro? te faqja 18 - pika 33 thuhet "Furnizim me automjete terreni" për nevoja të QKMF-së, prandaj kërkoi që të informohet se me sa automjete është furnizuar QKMF-ja dhe sa ka qenë vlera e blerjes se tyre; te faqja 19 – thuhet se ka pas ndëshkime ndaj 5 operatorëve ekonomikë në shumë prej 2462 euro, prandaj na intereson ta dimë se për cilat projekte bëhet fjalë dhe cilët janë ata operatorë të ndëshkuar; te faqja 30 – në fund të faqes flitet për procesin mësimor në gjuhën serbe e cila zhvillohet në 5 shkolla, dhe pyeti me çfarë planprogrami ligjërohet në ato shkolla dhe pse raportohet ndaras për këto 5 shkolla, pasi që ne mendojmë se nuk mund të ketë integrim duke bërë ndasi. Mandej tha se duke e analizuar tabelën e "Projekteve të realizuara gjatë vitit 2014 në Komunën e Vushtrrisë", në terren kemi gjetur shumë projekte që kanë mangësi në cilësinë e tyre, ku përveç shembujve nga fshatrat e sipërpërmendura, shembuj ku është investuar e që kanë cilësi të dobët në punimin e tyre janë edhe projektet në vijim: rehabilitimi i shkollës fillore "Ali Kelmendi" në Studime të Poshtme, ku thuhet se është investuar një shumë prej afërsisht 3000 euro, prandaj pyeti ku saktësisht janë investuar këto mjete, pasi ne pas vizitës tonë në atë shkollë hasëm në një gjendje të mjerushme të saj, sepse në atë shkollë, të gjitha klasët kanë shumë lagështi dhe shumë myk në muret e tyre, të cilat edhe kundërmojnë një aromë tepër të rëndë. Po ashtu, në këtë shkollë, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm, sikurse nuk ka as rrethojë e as ujë të pijshëm, dhe kjo shkollë vazhdimisht vërshohet nga kanali që gjendet në hyrje të oborrit të saj. Mandej lidhur me ndërtimin e fushës së futbollit në fshatin Mihaliq, tha se nga vizita që i kanë bërë kësaj fushe shihet qartazi se punimet në atë fushë janë të cilësisë tepër të dobët dhe kjo fushë nuk ka nivelizimin e duhur, meqë nuk është rrafshuar siç duhet, pasi që dheu të cilin e ka kjo fushë është i një cilësie aq të dobët, saqë më shumë përmban gurë sesa dhe, prandaj pyeti si është e mundur që një punim kaq i dobët i fushës të kushtojë kaq shumë para. Në fund tha se duke pas parasysh cilësitë kaq të dobëta në shumicën e projekteve të vitit 2014, Qendra e Lëvizjes Vetëvendosje kërkon që: projektet në të ardhmen të kenë cilësi më të mirë, të kenë çmime të arsyeshme; të intervenohet urgjentisht në shkollat të cilat janë të prekura nga lagështia dhe myku, i cili rrezikon seriozisht shëndetin e nxënësëve që vijnë në mësimet në to; të mos jenë përfitues të tenderëve kompanitë të cilat vazhdimisht nuk janë serioze në kryerjen e punimeve.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se është dashtë të informohen anëtarët e kuvendit me kohë që materiali për këtë pikë të rendit të ditës nuk do të na vjen i plotë, por një pjesë e tij do të jetë e publikuar në ueb-faqen e komunës, prandaj në këto rrethana nuk mund të paraqiten edhe vërejtjet reale lidhur me shpenzimet buxhetore, sidomos për të hyrat vetanake dhe të grantit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës. Pastaj tha se nëse shikohet LVL-ja dhe krahasohet me atë që u tha më lartë, atëherë jemi larg atyre kompetencave dhe përgjegjësisë që parashikohen në LVL, ku flitet për kompetencat ekskluzive të zhvillimi ekonomik, urbanizmi, arsimit, menaxhimi i pronave, kualiteti i ndërtimeve në komunë, higjiena, trajtimi i ujërave të zeza, sigurimi i ujit të pijshëm për qytetarë, tregjet, shëndetësia, arsimit dhe të gjitha sferat e jetës, prandaj kërkoi që t'i dërgohen me shkrim shpenzimet për reprezentacion, mëditje (a ka kursim në krahasim me periudhat e mëparshme), derivate të naftës, pasi që raportit në fjalë i mungojnë. Po ashtu kërkoi që të informohet sesi është gjendja me tatimin në pronë dhe taksat tjera komunale. Mandej tha se në raportin në fjalë nuk flitet fare rreth çështjeve të uzurpimeve, si temë e veçantë. Në vazhdim lidhur me zhvillimin e Sektorit të bujqësisë, thuhet se një pjesë e

madhe e fermave më nuk ekzistojnë, prandaj është i nevojshëm formimi i një komisioni nga kuvendi i komunës për të inspektuar gjendjen në terren, pasi që ka dyshime se për disa raste dikush ka manipuluar si në nivelin ministror ashtu edhe lokal, dhe shtoi se janë premtuar inkubatorë për zhvillimin ekonomik dhe janë premtuar edhe zona të biznesit. Gjithashtu kërkoi informatë për ndërtimin e fabrikës së ujit, pasi që është kaluar çdo afat i mundshëm. Mandej tha se një element i rëndësishëm është kontrollimi i kualitetit dhe standardeve të ndërtimeve, numri i pranimeve teknike dhe a ka dis-harmoni në mes të dhënies së lejes dhe ndërtimit faktik në terren. Në fund tha se Komuna e Vushtrrisë ka nevojë që ta ketë Zyrën për projekte, e cila do t'i ndihmonte qytetarët për përgatitjen e projekteve.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - sa i përket vërejtjeve lidhur me raportin në fjalë, tha se në ueb-faqen e komunës janë publikuar të gjithë përfituesit e subvencioneve, si dhe të gjitha projektet që janë menaxhuar nga Drejtoria për Prokurim Publik, por edhe projektet tjera që janë menaxhuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, si dhe nga Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Po ashtu tha se edhe në raportin në fjalë ka informim rreth shpenzimeve në detaje, duke shtuar se edhe në mbledhjen paraprake të KK-së Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka prezantuar një raport të shpenzimeve në detaje. Pastaj tha se në vitin e kaluar nuk ka pas planifikim as nga qeveria lokale dhe as nga ajo qendrore për pyllëzime të reja të pyjeve tona, duke shtuar se për vitet tjera mund të planifikohen pyllëzime të reja. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet dhe pyetjet e anëtarëve të kuvendit për raportin në fjalë. Në fund lidhur me shkollat serbe, tha se shkollat serbe nga viti 2006 kanë hequr dorë nga buxheti i Kosovës, duke shtuar se shëndetësia dhe arsimi serb në komunat e Republikës së Kosovës nuk menaxhohen nga qeveritë komunale, por as nga Qeveria e Republikës së Kosovës, por në këto dy segmente ku funksionon pushteti paralel.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet e bëra për gjendjen jo të mirë dhe për disa defekte në disa shkolla të fshatrave të Komunës së Vushtrrisë.

Abdullah Klinaku, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet e bëra për Sektorin e shëndetësisë në Komunën e Vushtrrisë.

Zoran Rakiç, anëtar i kuvendit - tha se shkollat serbe të Komunës së Vushtrrisë akoma nuk kanë hyrë në sistemin arsimor të Kosovës, por është duke u punuar në drejtim të integritimit në sistemin arsimor të Kosovës, pasi që në Drejtorinë për Arsim është punësuar një koordinatorë e cila po angazhohet për çështjet e arsimit, duke shtuar se nuk do të ketë zgjidhje individuale për çështjet e arsimit. Në fund tha se aktualisht mësimdhënësit serb nuk marrin paga nga buxheti i Kosovës, pasi që nuk janë pjesë e sistemit arsimor të Kosovës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet Raporti për situatën ekonomiko-financiare dhe realizimin e investimeve kapitale, si dhe Raporti i KKSB-së.

3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transportin rrugor në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Fatime Haziri, anëtare e kuvendit - tha se sa herë që diskutohet në kuvendin e komunës ndonjë çështje nga Drejtoria për Shërbime Publike, anjëherë nuk e shohim drejtorin e kësaj drejtorie në kuvend, prandaj kërkoi që herëve tjera drejtori të jetë prezent në kuvend. Pastaj tha se draft-rregullorja në fjalë është në tërësi kopje nga ligji, duke shtuar se draft-rregullorja është dashtë më shumë t'i dedikohet nevojave të komunës sonë sesa të jetë kopje e ligjit.

Islam Latifi, zyrtar i DSHP-së - tha se draft-rregullorja në fjalë nuk është kopje e ligjit, por e njëjta ka mbështetje ligjore, si dhe njoftoi se DSHP-ja ka organizuar diskutim publik me

qytetarë dhe me kategoritë e ndryshme të shoqërisë. Në fund tha se kjo draft-rregullore rregullon të gjitha çështjet e transportit rrugor të udhëtarëve.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për transportin rrugor në Komunën e Vushtrrisë.

4. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Vushtrrisë (shqyrtimi i dytë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për përdorimin e automjeteve zyrtare në Komunën e Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për ndarjen e bursave dhe shpërblime për nxënës (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë dhe shpërblime për nxënës.

Diskutimi publik fillon nga data 27 mars 2015 dhe zgjatë deri më 17 prill 2015.

6. Shqyrtimi i Informatës rreth procedurës së legalizimit të objekteve.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, kërkoi nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të mos legalizojë objektet kolektive për banim pa i plotësuar disa kritere kryesore, të cilat kanë të bëjnë me vendin për garazhim dhe parkim të automjeteve, të kenë lokacione për hapësira gjelbëruese dhe të kenë parkun për lojëra dhe rekreacione të fëmijëve.

7. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për hapjen e trasesë së rrugëve për vitin 2015.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që këtij propozim-vendimi t’i shtohet edhe hapja e një rruge në fshatin Beçuk në gjatësi prej 900 m, pasi që në këtë pjesë të fshatit gjendet një lagje prej 13 shtëpive, të cilët nuk kanë asnjë lidhje dhe dalje me rrugët tjera të asfaltuara.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- pyeti se a ka hyrë në listën me prioritet ndërtimi i rrugës në fshatin Pasomë e cila është në gjatësi prej 1 km, dhe e cila fillon nga shkolla dhe vazhdon të lidhet me asfaltin e fshatit Rashan.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit - propozoi që propozim-vendimit në fjalë t’i shtohet edhe rruga e tij në fshatin Stanoc i Poshtëm, e cila është në gjatësi prej 70 m, pasi që ka problem me kyçjen në rrugën e qarkullueshme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me pyetjen e anëtarit të kuvendit A.Januzi, sqaroi se rruga në fjalë është e planifikuar për t’u ndërtuar në këtë vit, duke shtuar se të gjitha rrugët e planifikuara për t’u shtruar në asfalt, janë në procedurë e sipër të realizimit të tyre.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - propozoi që të hedhet në votim propozim-vendimi në fjalë duke inkorporuar në të edhe propozimet e anëtarëve të kuvendit H.Mustafa dhe A.Bregaj.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim caktohen rrugët lokale të cilat do të hapen dhe do të trajtohen me zhavorr në Komunën e Vushtrrisë:

Rruga në fshatin Skoçne,

Rruga në fshatin Kunovik,

Rruga në fshatin Kurillovë,

Rruga në fshatin Beçuk dhe

Rruga në fshatin Stanoc i Poshtëm.

Hapja e trasesë së këtyre rrugëve publike dhe trajtimi i tyre me zhavorr do të bëhet me mjetet e planifikuara për vitin 2015.

8. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për caktimin e lokacioneve për parkingje publike.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se rruga kryesore e cila është zgjeruar është bërë përsëri e ngushtë, pasi që në të dy anët ka parkingje të automjeteve, dhe është ngusht kalimi i dy automjeteve, prandaj kërkoi që kjo çështje të rregullohet.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, propozoi që të hiqet paragrafi 1.3, pasi që ky lokacion duhet të shndërrohet në hapësirë gjelbëruese, e jo të bëhet parking i veturave, duke shtuar se hapësira gjelbëruese do të jetë edhe në favor të zhvillimit të aktiviteteve biznesore nga lokalet përreth saj.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim caktohen lokacionet për rregullimin e parkingjeve publike në Komunën e Vushtrrisë:

Sipërfaqja prej 1,225 m² në ngastrat kadastrale 504 dhe 505 te ish-stadiumi i hendbollit, Sipërfaqja prej 630 m² në ngastrën kadastrale 598/2 prapa banesave që gjenden përballë Kalasë së qytetit,

Sipërfaqja prej 273 m² në pjesën e rrugës publike përballë palestrës së sporteve “Jeton Tërstena”.

Rregullimi i këtyre hapësirave për parkingje publike do të bëhet me mjetet e planifikuara për vitin 2015, ndërsa menaxhimi i tyre do të bëhet në bazë të Rregullores për parkingje publike që do të hartohet nga Drejtoria për Shërbime Publike.

9. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë propozoi që çmimi fillestar për m² të jetë 2 euro.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 21 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e objektit pronë e paluajtshme e Komunës së Vushtrrisë, e cila gjendet në rrugën “Ismail Qemajli” në Vushtrri, ngastra

kadastrale Nr. P-70202016-00086-0, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e komunës, e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 39 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 125 m². Objekti i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit për personat fizikë dhe juridikë, si objekt i karakterit të përkohshëm (montazh) në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve me mundësi vazhdimi edhe për pesë (5) vite tjera; Çmimi fillestar për m² është dy (2) € në muaj.

10. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit për lejimin e mjeteve financiare për renovimin e zyrave të Shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dobësuar “Drita Jonë”.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, përveç ndarjes së mjeteve financiare, propozoi që të planifikohet në vitin e ardhshëm dhënia e një automjeti për nevojat e shoqatës në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Vendim lejohen mjete financiare në vlerë prej dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë e nëntëdhjetë e pesë (2,458.95) € për renovimin e zyrave të Shoqatës për persona të verbër dhe shikim të dobësuar “Drita Jonë”, të cilat gjenden në objektin e ish-TMK-së.

Mjetet financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi lejohen konform Rregullores 01.Nr37-2/11 dt.24.02.2011 për caktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.

Për shfrytëzimin e mjeteve financiare të cekura në pikën 1 të këtij Vendimi obligohet përfaqësuesi i OJQ-së që të lidhë marrëveshje me Komunën e Vushtrrisë.

11. Shqyrtimi i Korrigjimit të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale, konform kërkesës së komisionit të përbashkët MF/MAPL.


Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë Rregullore korrigjohet Rregullorja 01nr.20/15, dt.29.01.2015 duke e fshirë fjalën “KES/CO” nga paragrafi 1.12 lidhur me paragrafin 7.3, ndërsa pjesa tjetër e tekstit të këtij paragrafi mbetet e pandryshueshme.

12. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11:43.

Albanez Tahiraj



Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrova

